

# **STATUTI**

## **I Shoqërise me përgjegjësi të kufizuar “GRIFI KONSTRUKSION” shpk**

Personi që firmos si me poshtë:

- Hasan GRIFI lindur me date 01.04.1964, ne Mat, dhe banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtes i dokumentit të identifikimit me ID, G40401199H.

Në baze te Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 “ Për Tregëtarët dhe Shoqërite Tregëtare “, krijojne Statutin e ketij subjekti, perkatesisht Shoqërise.

### **KREU 1**

#### **Themelimi, Forma, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia.**

##### **Neni 1**

###### **Data e Themelimit, Forma, dhe Themeluesit.**

- (1) Sot me date 12.08.2022, themeluesi, Hasan GRIFI, ka vendosur, te krijoje nje shoqeri me përgjegjësi te kufizuar, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, sipa Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqërite Tregëtare “, dhe aktet e tjera nenligjore qe jane ne fuqi. Shoqeria është nje person juridik Shqipetar, i cili do te ushtroje aktivitetin privat ne territorin e Republikes së Shqiperise, pas regjistrimit ne QKB.
- (2) Themelues i Shoqërise eshte;
  - Hasan GRIFI, me ID nr G40401199H, atesia DALI, i datëlindjes 01.04.1964, me adrese Njesia Bashkiake nr 7, Bathore, Bashkia Kamez, Tirane.

##### **Neni 2**

###### **Emërtimi**

Emri i Shoqërise është “GRIFI KONSTRUKSION” shpk

##### **Neni 3**

###### **Objekti**

- Shfrytezim me karriere I mineraleve metalore dhe jo metalore sipas llojeve dhe kategorive.
- Hapje dhe shfrytezim gurore me karriere, mbledhja, perpunimi industrial dhe artisanal si dhe tregtimi I gureve dekorativ.
- Import-eksporti I mineraleve metalore dhe jometalore sipas te gjitha kategorive.
- Prodhim dhe tregtim material ndertimi, si gur I thyer, granil, beton, asfalto-beton, gelqere etj.
- Perdorimi, magazinimi i materialeve plasese dhe shperthyese si dhe transportimi i tyre per nevojat e vere shoqerise.
- Tregtim dhe perdorim i makinerive industrial
- Transport mallrash te ndryshem brenda dhe jashte vendit.
- Prodhim perpunim dhe tregtim i materialeve te hekurit.
- Germime dheu ne punime eventuale, murature e beton – arme, prishje dhe punime ne toke te germuar.



- Prodhim material inerte – gure.
- Prodhim element betoni e betonarme te zakonshme – paranderur – gure dekorativ.
- Ndertime civile, industrial, turistike, bujqesore deri e 5 kate dhe mbi 5 kate.
- Rikonstruksione, ndertim rruges sipas te gjithave kategorive.
- Punime te mirmbajtjes dhe te sinjalizimit ne rruge, ndertim te mbishtresave dhe nenshtresave rrugore.
- Ndertim ura dhe vepra arti deri ne 10 m.
- Ndertime – Kanalizime – Ujesjellesa – Kanale e Impiante vaditese, punime mbrojtje te sistemit hidraolik – cemento etj. Ndertime diga – damba deri ne 10 m.
- Punime karpentjerie druri.
- Punime karpentjerie metalike. Instalim i impianteve higjenike, guzhina, lavanteri, hidrosanitare e mirmbajtja e tyre.

#### **Neni 4**

##### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërise, do te jete e pakufizuar. Ajo mund te Shpërbehet ne çdo kohe me vendim te asamblese se Ortakeve

#### **Neni 5**

##### **Selia**

- (1). Selia e Shoqërise ndodhet ne adresen: Lagja numer 3, Rruga Demokracia Banesa numer 17, Tirane.
- (2) Adresa e faqes zyrtare te Internetit eshte: grifihasan@gmail.com.
- (3) Adresa e Shoqërise, per qellime komunikimi elektronik ( nese ka ) eshte si vijon grifihasan@gmail.com.

#### **Neni 6**

Shoqëria ka Vulen e saj ku jane te percaktuara inicialet e emertimit te saj, NIPT-i dhe adresa baze.

## **KREU II**

### **Kapitali**

#### **Neni 7**

##### **Kapitali Themeltar**

Kapitali fillestar, njekohesisht dhe Kapital Themeltar i Shoqërise eshte; 1 500 000 (nje million e peseqind mije) Leke, perkatesisht ne nje kuote me vlere nominale 1 500 000 (nje million e peseqind mije) Leke.

Kapitali Themeltar perbehet nga kontribute ne vlere monetare ne shumen 1 500 000 (nje million e peseqind mije) Leke.

#### **Neni 8**

Pjesemarrja e themeluesve ne Kapitalin Themeltar te Shoqërise eshte ne përputhje me kontributet e meposhtme;

- Ortaku Hasan GRIFI , zotërues i 1 ( nje ) kuote me vlere te pergjithshme, 1 500 000 Leke, që përbën 100 % te Kapitalit Themeltar te Shoqërise.



## **Neni 9**

### **Zmadhimi dhe zvogelimi i Kapitalit.**

Kapitali i Shoqërise mund të zmadhohet nepermjet nenshkrimeve të pjeseve të Kapitalit Themeltar për kontributet në para dhe kontributet në natyrë, gjë e cila arrihet nepermjet emerimit në rrugë ligjore të një eksperti të autorizuar, për këto kontribute sipas kërkesës së paraqitur nga një person i autorizuar nga të gjithë ortakët.

Në asnjë rast, shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin e Shoqërise.

Zvogelimi i Kapitalit, lejohet nga Asambleja e Ortakeve, e cila merr vendime në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e Statutit.

Në të gjitha rastet, zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjeseve të kapitalit që përfaqesojnë.

## **Neni 10**

### **Transferimi i Kapitalit**

Kuotat e Kapitalit në një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen, apo kalohen nëpërmjet;

- a. Kontributit në kapitalin e Shoqërise
- b. Shitblerjes
- c. Trashëgimisë
- d. Dhurimit
- e. Çdo mënyrë tjetër e parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar, janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në Statut.

Pjesët e Kapitalit Themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

## **KREU III**

### **Organet vendimarrëse dhe drejtuese**

## **Neni 11**

### **Organet Vendimarrëse**

Asambleja e Ortakeve, është organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve, është organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të Statutit, sipas modaliteteve të përcaktuara me ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme;

- Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërise.
- Ndryshimet e Statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e Administratoreve.
- Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe Eksperteve Kontabel të Autorizuar.
- Përcaktimin e shpërblimeve për Administratorët, Likujduesit dhe Ekspertët Kontabel të Autorizuar.
- Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë edhe paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve për ecurinë e veprimtarisë.
- Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.

- Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit.
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Perfaqesimin e Shoqerise ne Gjykata te te gjitha niveleve si dhe ne procedimet e tjera ndaj Administratoreve
- Perfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me Organet e Qeverisjes Qendrore dhe Lokale.
- Riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise.
- Miratimin e rregullave procediriale per thirrjen dhe zhvillimin e Mbledhjeve te Asamblese se Ortakeve.
- Çështje te tjera te parashikuara nga ligji apo nga Statuti.

Nje Ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve, ne baze te nje autorizimi, nga nje Ortak Tjeter, apo nje person i tretë.

Administratori I Shoqerise ( ne rastin kur nuk eshte Ortak ), nuk mund te veproje si perfaqesues I ortakeve ne Asamblene e Pergjithshme.

Autorizimi I perfaqesimit mund te jepet vetem per nje mbledhje asambleje te pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

## **Neni 12**

### **Menyra e thirrjes se Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve**

- (1) Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet njoftimit me shkrese ose, nese parashikohet nga Statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese, apo me mesazh elektronik duhet te permbaje; vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites. Ky njoftim duhet t'u dergohet te gjithe ortakeve jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
- (2) Kur Asambleja e Pergjithshme nuk është thirrur sipas pikes 1 te këtij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakort, për te marre vendime pavarsisht parregullsisë.

## **Neni 13**

### **Kuorumi**

- (1) Në rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 ( tridhete ) per qind te kuotave.
- (2) Ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87, te ligjit " Per tregetaret dhe Shoqerite tregetare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numerit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese,apo mjete elektronike,sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.
- (3) Nese Asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me lart,asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite,me te njejtin rend dite.

## **Neni 14**

### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit,te ortakeve pjesemarres,per ndryshimin e statutit,zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar,shperndarjen e fitimeve,riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.



Asambleja e pergjitheshme vendos me shumicene votave te ortakeve pjesemarres,per ceshtje te tjera si:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise,
  - b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve,
  - c) Emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te experteve kontabel te autorizuar,
  - d) Percaktimin e shperblimeve,
  - e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,perfshire paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
  - f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve,
  - g) Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese,
- Cdo ndryshim statute duhet t e depozitohet ne QKR duke pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

#### **Neni 15**

##### **Perjashtimi nga e drejta e votes**

1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:
  - a) Vleresimin e veprimtarise se tij,
  - b) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij,
  - c) Ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria,
  - d) Dhenjen ose jo te perfitimeve te reja.
2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues I autorizuar,I autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi,ashtu si edhe ortaku qe perfaqeson.

#### **Neni 16**

##### **Administrimi**

- (1) Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise.Afati I emerimit eshte 5 vjet,me te drejte ripertesitje.Emerimi I administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- (2) Administratoret e nje shoqerie tregtare meme,sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji,nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar anasjelltas.Cdo emerim i bere ne kundershtrim me keto dispozita eshte i pavlefshem.
- (3) Personat e meposhtem caktohen si Administratore te pare te shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se pergjithshme.

Te dhenat e identifikimit:  
(mbiemrat,emrat,adresat)

dhe specifikimet e nenshkrimet:

\_\_\_Hasan GRIFI\_\_\_\_\_ me ID : G40401199H\_\_\_\_\_

Atesia; DALI

Datelindja: 01.04.1964, me adrese; Njesia Bashkiake nr 7, Bathore, Bashkia Kamez, Tirane.



## **Neni 17**

### **Kompetencat e Administratoreve**

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen të:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te Shoqërise, doke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme.
- b) Përfaqesojne Shoqerine tregtare.
- c) Kujdesen për mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoqerise.
- d) Përgatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, I paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se pergjithshme per miratim.
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, që kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e Shoqerise.
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te Shoqerise, siç parashikohet ne Ligjin per Qëndren Kombetare te Regjistrimit.
- g) Raportojne perpara asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te veçante per veprimtarine e Shoqerise tregtare.
- h) Kryejne detyra te tjera te percaktuara me ligj dhe me statut.

Administratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjithshme ne rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqerise nuk I mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive , te cilat kane nje vlere me te larte se 20 % te aseteve te Shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.
- Shoqeria brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak, pasuri qe kane vlere me te larte se 20 % te aseteve te Shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.

Nese Asambleja e Pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e Pergjithshme, mund te shkurtoje administratorin, ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin e Administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore te punes, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne Fuqi.

## **Neni 18**

### **Përgjegjësia e e administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj Shoqerise ose ndaj të tremeve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faje te te kryera gjate administrimit te Shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga Asambleja, qe I sjellin dem Shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe Ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat ekonomike perkatese.

1. Përveç sa është parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 te ligjit " Per Tregtetaret dhe Shoqerite Tregtare ", administratori detyrohet;



- a. Te kryeje detyrat e tij te percaktuara me ligj dhe ne statut, me mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke I kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis.
  - b. Te ushtroje kompetencat qe I njohen me ligj dhe me Statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita.
  - c. Të vleresoje me pergjegjesi çështjet per të cilat merret vendim.
  - d. Te parandalpje dhe menjanoje rastet e konfliktit , prezent, apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqërise.
  - e. Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.
2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj Shoqerise per çdo veprim apo mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e Shoqerise Tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer me mirebesim.
  3. Nese, Administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 dhe 2 te ketij neni, eshte I detyruar t'I demshperbleje Shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal, qe ata apo, personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt, e sipas standarteve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj Shoqerise ne menyre solidare.
  4. Në mënyre te veçante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte I detyruar t'I demshperbleje Shoqerise demet e shkaktuara nese, ne kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 " Për Tregëtarët dhe Shoqerite Tregëtare ", kryen veprimet e meposhtme:
    - U kthen ortakeve kontributet
    - U paguan ortakeve interesa apo dividente
    - U shperndan aktivet e Shoqerise
    - Lejon qe Shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare kur ne baze te gjendjes financiare, duhet te parashikohej qe Shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet.
    - Jep kredi.

Pavec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te njekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe I eshte shkaktuar shoqerise perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim I asamblese nuk mund te pengoje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

#### **KREU IV**

##### **Viti financiar – ekspertet**

##### **Neni 19**

##### **Viti financiar**

Viti financiar I shoqerise fillon me date 1 janar dhe perfundon me date 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.



## **Neni 20**

### **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise,ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille I ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel I autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe ate per kontrollet periodike te ushtruara,te cilat eshte I detyruar qe tja paraqese e dorezoje ne kohe reale ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

## **Neni 21**

### **Prishja dhe likujdimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgatja e parashikuar ne themelimin e saj,
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve,
- c) me hapjen e proceduarave te falimentimit,
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723,date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"
- e) me vendim te gjykates.

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilen parashikojne menyren e likujdimit te shoqerise,duke caktuar 1 apo disa likujdatore dhe shenuar ne cdo dokument prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likujdim e siper".Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise pagueese,me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga ortaket.

Nese ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likujduesve,brenda 20 diteve pas prishjes,cdo person I interesuar mund ti drejtohet gjykates,per te caktuar nje likuidues.

## **Neni 22**

### **Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja**

Shoqeria mund te ndahet,bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve,ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

## **Neni 23**

### **Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statutdhe dispozitat e legjislacionit shqipetar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut do te bazohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",kodi Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.



**Neni 24**

**Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per vdo mosmarreveshje qe mund te linde mes Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKU  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**Hasan GRIFI**

Hasan Grif

